

KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga Qëndresa Qytetare

Më datë 18 nëntor 2024 u organizua në Tiranë workshop-i mbi Transparencën dhe Demokracinë e brendshme në Universitetet Publike. Në këtë takim në të cilin nga KLSH morën pjesë z. Aulent Guri dhe znj. Esmeralda Hoxha u prezantuan rezultatet e Raportit të Monitorimit “Universitetet në sitën e transparencës financiare”. Vlera e këtij monitorimi konsiston jo vetëm në përdorimin e të dhënave nga studentë, pedagogë, drejtues akademikë apo administrativë, vetë qeveria apo KLSH në kuadër të auditimeve, por edhe ekspertë që kanë interes të studiojnë menaxhimin e universiteteve publike.



Qëndresa Qytetare përmes këtij monitorimi synon të nxisë llogaridhënien publike të universiteteve ndaj studentëve dhe të stimulojë një nivel më të lartë transparence, nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në vendimmarrje.

Pas përfundimit të prezantimit të raportit të monitorimit mbi transparencën financiare të universiteteve fjalën e mori Zv. Rektori i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, Prof. Azeta Tartaraj e cila përgëzoi ekspertët e Qëndresës për punën e bërë dhe adresimin e problematikave.



Ajo ftoi studentët dhe grupet e interesit të ngrenë zërin e tyre duke ju drejtuar institucioneve të ndryshme sa herë e shohin të arsyeshme për padrejtësi të ndryshme që ndikojnë në procesin e mësimdhënies.

Më tej, referuar edhe axhendës, fjalën e mori z. Aulent Guri i cili theksoi edhe një herë rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies të të gjitha institucioneve publike të cilat njëkohësisht janë edhe parimet kryesore në të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit operon dhe promovon. Në diskutimin e tij z. Guri u ndal në disa prej gjetjeve kryesore të Raportit të Monitorimit të Qëndresës Qytetare duke vlerësuar mbi të gjitha “presionin” pozitiv që kjo organizatë ushtron prej vitesh tek universitetet publike me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike nga ana e tyre.